

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ NRD-compani-03 ” sh.p.k**

Sot me datë 06/06/2023, une **Driton Džaviti**, person me shtetesi shiptare, i datelindjes 02/12/1975, Mbajtes i kartes me nr ID H 51202137 V me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nenshkruaj ketë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ NRD-compani-03 sh.p.k ”

Neni 1

Forma e shoqërisë

Ortaku themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tij është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.

Neni 2

Emertimi i shoqërisë

Emertimi i shoqërisë është “ NRD-compani-03 sh.p.k ”

Neni 3

Baza juridike

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në përputhje me dispozitat e Statutit e Aktit të Themelimit.


Neni 4

Objekti i veprimtarisë

4.1 Veprimtaria e Shoqërisë “ NRD-compani-03 sh.p.k ” do të ketë për objekt :

Import kafeje, produkteve të çajrave, kakaos, të ekspreseve, mulli kafeje, produkteve ndihmese si filxhane kafeje, filxhane çaji, kapsula kafeje dhe produkte të ngjashme me to.

4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të



parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe perdore financime nga ortaket, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.

4.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të administratorit.

Neni 5 Selia

4.1. Shoqëria “ NRD-compani-03 sh.p.k ”

Rruga Pavarsia e Kosoves , nr 2504, prane Market Vokrri, Qerret, Kavaje.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë


Kapitali themeltar i shoqërisë “ NRD-compani-03 sh.p.k ” është 500.000 (peseqindmije) Leke.

Kapitali do të ndahet në 1(një) kuot.

Neni 8 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë z. **Driton Džaviti** me nr ID H 51202137 V.



Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10

Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 11

Juridiksioni

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar , eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruset rregullisht nga ortak themelues.

ORTAKU I SHOQERISE

“ NRD-compani-03 sh.p.k ”

Driton Džaviti

DRITON DŽAVITI

